




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Predcednika / Office of the Mayor

Në mbështetje të Statutit të Komunës së Skenderajt si dhe nenit 9, pika 1/4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së, për KKSBS-së dhe nenit 7.3 të ligjit Nr. 04/L-76 për Policinë, Kryetari i Komunës:

THËRRET

Mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), e cila do të mbahet më 4 shtator : duke filluar nga ora 11:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve në ndërtesën e Komunës.

Për këtë mbledhje propozon këtë :

REND DITE:

- Miratimi i rendit të ditës
- Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- Raport pune për periudhën 6 mujore të KKSBS-së (raporton Kryetari i Komunës, z.Fadil Nura)
- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë
- Diskutim rreth fillimit të vitit të ri shkollor
- Të ndryshme



Ekstrakt nga procesverbali I mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, i mbajtur me 03.07.2024

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika të rendit të ditës:

- **Diskutim rreth përgatitjeve për pritje të bashkatdhetarie**
- **Siguria në komunikacion**
- **Diskutim rreth mbarëvajtjes së sezonit të korrje shirjeve**
- **Diskutim rreth çështjeve të sigurisë**
- **Të ndryshme**

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Përshendetje të gjithëve! Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Kourimin e kemi, besoj materialin e keni marrë me kohë. E qes në votim rendin e ditës. Kush jeni për që të punohet sot me këtë rend të ditës? Faleminderit të gjithëve, atëherë vazhdojmë me pikën tjetër diskutim rreth përgatitjeve për pritje të bashkatdhetarëve. Me ne është edhe drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, Alban Berisha, i cili do të na njoftojë me përgatitjet për pritje të bashkatdhetarëve. Urdhëro drejtor.

Alban Berisha, drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport: Faleminderit kryetar! Përshendetje për të gjithë. Edhe këtë vit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës, organizon aktivitete të ndryshme për bashkatdhetarë. Jemi përgatit një sërë aktivitete, aktualisht jemi duke e finalizuar agjendën e aktiviteteve, që do të jenë për 30 ditë aktivitete të ndryshme, argëtuese, sportive, rekreative etj.

Kryetari Nura: Propozoj t'i dërgohet agjenda edhe Policisë së Kosovës, në mënyrë që të jetë e njoftuar edhe ajo dhe të ofrojë siguri gjatë realizimit të aktiviteteve.

Agron Kajtazi: Përshendetje të gjithëve. Do të jenë këta muaj të ngarkuar me bashkatdhetarë. Uroj të kemi një program të mirë për pritje të bashkatdhetarëve.

Muhamet Kajtazi (Policia e Kosovës): Policia e Kosovës fillon të implementojë planin operativ që përfshin edhe periudhën e ardhjes së bashkatdhetarëve, kështu që Policia e Kosovës është e gatshme për gjithçka.

Kryetari Nura: Është mirë të kemi koordinim gjatë këtyre ditëve. Të jemi më tolerantë ndaj bashkatdhetarëve, në komunikacion, etj.

Mihane Bekteshi: Një pyetje kam për drejtorin Alban Berisha. A do të orar të muzikës gjatë programit në shesh?

Alban Berisha: Po, muzika në kuadër të programit do të jenë nga ora 20:30 deri në 23:00.

Kryetari Nura: E qes në votim këtë pikë të rendit të ditës. Faleminderit të gjithëve, pra me votat e të gjithë të pranishmëve kalon kjo pikë. Vazhdojmë me sigurinë në komunikacion. Urdhëro komandant.

Muhamet Kajtazi: Faleminderit kryetar. Sa i përket sigurisë në komunikacion, gjendja është e mirë. Kemi rënie të rasteve si në aksidente ashtu edhe të tiketave të shqiptuara. Në qershor kemi 35 raste të veprave të ndryshme në komunikacion. Si polici kemi vazhdimisht

angazhim. Jemi në koordinim të plotë me institucionet tjera dhe jemi të përgatitur për sezonin e ardhjes së bashkatdhetarëve. Një problem e kemi, mungesën automarimanges dhe hapësirën për parkim të veturave të konfiskuara. Ka raste të vozitjes së shpejtë në disa rrugë të qytetit.

Kryetari Nura: Sa i përket automarimangës, besoj do të kryhet shumë shpejt edhe kjo çështje. Jemi në pritje të kthimit të ligjshmërisë së vendimit. Komuna do të jetë e gatshme të bashkëpunojë me Policinë e Kosovës për sigurinë në komunikacion dhe për çështje tjera të interesit të përgjithshëm.

Agron Kajtazi: Pas reshjeve të shitur, në disa rrugë ka zhavorr, të pastrohen rrugët.

Muhamet Kajtazi: Në Llaushë është një pjesë e rrugës e dëmtuar.

Ibrahim Hoti (Këshilli i Bashkësisë Islame): Në Polac, afër xhamisë rruga është keq dhe po ka aksidente rrugore. Edhe kanalizimi aty po derdhet në rrugë.

Kryetari Nura: Me vërejtjet që u dhanë në këtë pikë dhe me premtimin që Komuna do të ndërmarrë veprime për këto çështje, e qes në votim edhe këtë pikë, kush jeni për? Faleminderit shumë! Kalojmë te pika tjetër, ajo rreth përgatitjeve për sezonin e korrjeshirjeve. Fjalën ia kaloj drejtorit për Bujqësi, Behxhet Maliqi, urdhëro drejtor.

Behxhet Maliqi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural): Faleminderit kryetar dhe përshendetje për të gjithë. Si drejtori kemi propozuar formimin e komisionit për mbarëvajtje të fushatës. Nga niveli qendror kemi vendimin për caktimin e çmimit të korrjes. Janë rreth 20 autokombajna që përfshihen në korrje e grurit. Të gjitha përgatitjet janë bërë për të filluar dhe mbaruar mbarë kjo fushatë.

Agron Kajtazi: Shqetësim mbetet djegia e hamulloreve gjë që po paraqet rrezik. Të zhvillohet një fushatë vetëdijesuese për këtë dukuri.

Behxhet Maliqi: Edhe sivjet do të kemi fushatë vetëdijesuese sikur vitin e kaluar. Djegia po bëhet nga mosdija.

Qefserë Duaui (Zyra për Barazi Gjinore): Të përgatiten dhe të shpërndahen broshura në kuadër të kësaj fushate vetëdijesuese.

Kryetari Nura: Kërkoj nga të gjithë këtu si anëtarë të KKSB-së që të thirret për kujdes dhe mosdjegie të hamulloreve. Me thirrjet për kujdes të shtuar dhe me rekomandimin që edhe Bashkësia Islame e Kosovës të informojë xhematin mbi rrezikun e djegies së hamulloreve, e qes në votim edhe këtë pikë, kush jeni për? Faleminderit të gjithëve, kalojmë te pika e sigurisë së përgjithshme, fjalën e ka komandanti i Policisë.

Muhamet Kajtazi: Siguria është e qetë, e mirë dhe në nivel të kënaqshëm, përfshirë edhe në lokalitetet ku ka serb. Situata është shumë e mirë. Nëse keni ndonjë pyetje, çështje, urdhëroni lirisht.

Kryetari Nura: A janë duke funksionuar kamerat e sigurisë?

Muhamet Kajtazi: Kamerat janë duke funksionuar normalisht.

Kryetari Nura: Faleminderit komandant, nëse nuk keni ndonjë pyetje, e qes në votim edhe pikën e sigurisë së përgjithshme. Kush jeni për? Faleminderit shumë të gjithëve! Kalojmë te pika “te ndryshme”. Dua të ju njoftoj se Komuna e Skenderajt do të vazhdojë bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës, në kuadër të marrëveshjes për mbulimin e shpenzimeve të varrimit.

Ibrahim Hoti: Faleminderit kryetar. Megjithatë kemi një kërkesë që çmimi për një rast të vdekjes dhe varrimit të tij të bëhet 300 euro, nuk është kërkesë e BIK-ut kjo, por e rrethanave që kanë ndryshuar, janë rritur cmimet, prandaj. Jemi 24 orë në shërbim të qytetarëve. Brenda një viti kemi nga 280 deri 320 raste të vdekjeve.

Mihane Bekteshi: A mund të kthehet tradita e mëhershme që në ceremoninë e varrimit, njerëzit t’i lënë nga 1 euro në varrim?

Ibrahim Hoti: Kjo është në vullnetin e njerëzve. Nuk mund t’u imponohet. Sa i përket dy çështjeve tjera, imami në Klinë të Epërme, Elbasan Mangjollli është pajtuar të punojë sipas rregullores së Bashkësisë Islame. Kemi pas takime në Prishtinë për këtë çështje me nivelin e lartë, dhe jemi pajtuar që kjo të bëhet sipas rregullores së BI-së. Mirëpo, ka ardh një grup qytetarësh nga Klina e Epërme dhe është shprehur kundër këtij hoxhes. Ata nuk e duan hoxhen në xhaminë e fshatit të tyre. Unë jam që të respektohet vendimi i nivelit qendror (BI-së), që të vazhdohet bashkëpunimi me imamin në fjalë. Cfarido veprimi i qytetarëve kundër këtij vendimi, do të ketë pasoja, do të bëhet keq.

Kryetari Nura: Faleminderit të gjithëve! Sa i përket çështjes së imamit në Klinë të Epërme, është çështje që i takon Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Këshillit në Skenderaj. Besoj do të gjendet mirëkuptimi mes palëve. Nëse nuk keni dicka tjetër, e përfundoj këtë mbledhje. Faleminderit edhe një herë dhe mirupafshim në takimin e ardhshëm.

Procesmbajtësi:

Jeton Rushiti

